



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 44

Tiranë – E hënë, 11 mars 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 123 datë 6.3.2024	
Për një shtesë në vendimin nr.501, datë 25.8.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve afganë dhe personave pa shtetësi, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën Islamike të Afganistanit, dhe për krijimin e task-forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuësve të mbrojtjes ndërkombëtare”, të ndryshuar.....	4825
Korrigjim gabimi material në ligjin nr. 20/2024, datë 22.2.2024, “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.42, datë 7.8.2023.....	4825



VENDIM

Nr. 123 datë 6.3.2024

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR.501, DATË 25.8.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN E
MBROJTJES SË PËRKOHSHME
SHTETASVE AFGANË DHE
PERSONAVE PA SHTETËSI, ME
VENDQËNDRIM TË PËRKOHSHËM
OSE TË PËRHERSHËM NË
REPUBLIKËN ISLAMIKE TË
AFGANISTANIT, DHE PËR KRIJIMIN E
TASK-FORCËS PËR MENAXHIMIN E
FLUKSIT TË KËRKUESVE TË
MBROJTJES NDËRKOMBËTARE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 82, të ligjit nr.10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/2, të vendimit nr.501, datë 25.8.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënie e mbrojtjes së përkohshme shtetasve afganë dhe personave pa shtetësi, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën Islamike të Afganistanit, dhe për krijimin e task-forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuësve të mbrojtjes ndërkombëtare”, të ndryshuar, shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

“2/3. Me përfundimin e afatit të përcaktuar në pikën 2/2, të këtij vendimi, personave që ndodhen ende në territorin e Republikës së Shqipërisë u shtyhet qëndrimi deri në datën 24.8.2024.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit,

Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në ligjin nr. 20/2024, datë 22.2.2024, “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.42, datë 7.8.2023, në pikën 7 të nenit 6 të marrëveshjes bëhet korrigjimi i gabimit material, si më poshtë:

Ishte:

7. Autoritetet kompetente të palës italiane do të përballojnë çdo shpenzim të nevojshëm për akomodimin dhe trajtimin e subjekteve që do të strehohen në strukturat e përmendura në aneksin 1, duke përfshirë ushqimin, kujdesin shëndetësor (përfshirë rastet kur për këtë kërkohet asistencë e autoriteteve shqiptare) dhe çdo shërbim tjetër që do të vlerësohet i nevojshëm prej **palës italiane**, duke u kujdesur që ky trajtim të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas së drejtës ndërkombëtare.

Bëhet:

7. Autoritetet kompetente të palës italiane do të përballojnë çdo shpenzim të nevojshëm për akomodimin dhe trajtimin e subjekteve që do të strehohen në strukturat e përmendura në aneksin 1, duke përfshirë ushqimin, kujdesin shëndetësor (përfshirë rastet kur për këtë kërkohet asistencë e autoriteteve shqiptare) dhe çdo shërbim tjetër që do të vlerësohet i nevojshëm prej **palës italiane**, duke u kujdesur që ky trajtim të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sipas së drejtës ndërkombëtare.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 16 lekë